

Besimtari

Gazetë mujore. Botues: Shoqata Bamirëse Islame Shkodër
Viti III i botimit, Korrik 2009 Nr. 27. Çmimi 20 lekë.
www.gazetabesimtari.com; e-mail: gazetabesimtari@yahoo.it

Kryeredaktor Selim Gokaj

PARTISE MUSLIMANE I GRABITEN VOTAT NE QARKUN E SHKODRES

Sapo kanë perfunduar zgjedhjet parlamentare ne Shqiperi dhe fituesi i ketyre zgjedhjeve tashme eshte i njohur. Per here te pare ne keto zgjedhje konkuroi edhe Partia Demokratike e Bashkimit Musliman Shqiptar e cila eshte rregjistruar me vendim gjykate dhe ishte e rregjistruar ne komisionin zgjedhor me numurin 16. Kjo parti nuk hyri ne zgjedhje per te rrembyer vota nga Partia Demokratike, as nga partia Socialiste, por hyri nr keto zgjedhje per te mbrojtur identitetin e muslimaneve i cili direkt, ose indirekt eshte i kercenuar nga segmente shteterore dhe mediatike qe e kane barazuar fene islame me dukuri te cilat nuk jane pjese e fese islame. Pasi beri nje fushate modeste dhe te ndershme, ajo e shikoi vehten se hapësirat e saj per te shpalose programin dhe strategjine ishin shume te kufizuara ne raport me partite e tjera qe paten mundesi monetare me bollek dhe pozuan ne media pa sforcime financiare, ne nje kohe qe ishte e pamundur qe partia e muslimaneve te shfrytezonte keto media te cilat afronin cmime astronomike per shfrytezuat ekranet etyre per fushate elektorale. Pavaresisht nga mundesite e kufizuara financiare, ne qarkun e Shkodres, me punen e perkushtuar te stafit te saj, u arrit qe te sensibilizohet ajo pjese e elektoratit qe ishte ne nje linje me platformen e partise muslimane e cila e mirepriti daljen e ketij formacioni politik dhe ishte e gatshme ta mbeshteste ate dhe me voten e saj. Pasi u bene takime ne Shkoder dhe Kopluk me elektoratin dhe u realizua nje interviste ne ekranin e TV Koplikut, u pa qarte se Partia Demokratike e Bashkimit Musliman Shqiptar kishte njerez te afte dhe me reputacion cilesor, ku spikaste figura e Kryetarit te Partise, Sabri Jacaj, nje figure kjo e kompletuar dhe shume mbreselene per aftesite e tij oratorike dhe pastertine e tij morale dhe ekonomike. Ata qe e ndoqen permes mediave mbeten te shokuar nga forca argumenteve qe ai perdori per te shpalose platfor-



men e partise dhe pikesynimet e saj ne mbrojtje te identitetit te muslimaneve. Pjese e fushates elektorale ishin edhe takimet qe u realizuan ne nje numur te madhe fshatrash ne Malesi te Madhe dhe ne Shkoder nga grupet e punes se Partise Muslimane te cilat u mirepriten dhe u perkrahem me premtimin per t'ia dhene voten deputeteve te Partise Muslimane. Por, gjate fushates dhe takimeve qe pati me elektoratin e saj, Partia Muslimane nuk i pati ne linjen e saj institucionet islame te cilet, permes qarkoreve, urdheruan imamet e xhamiave qe te mos lejonin perfshirjen e ambjenteve te xhamiave ne fushaten elektorale duke u kujtuar edhe imameve te xhamiave qe te mos perfshinin ne hytbe biseda per partite politike., ne nje kohe qe i kemi pare dhe ndegjuar te bejne thirrje te hapura ne hytbe per te votuar xhemati per nje formacion politik i cili i ka hapur shume pune muslimaneve me qendrimin e tij ndaj tyre. Qarkoret qe iu derguan imameve te xhamiave ishin pjese e zba-

timit te nje urdheri qe kishte ardhur nga KMSH. Por pati edhe imame xhamiash qe e penalizuan Partine Muslimane, ashtu si pati imame qe me te drejte nuk e moren parasysh qarkoren, por bene thirrje per te votuar per Partine Muslimane. Nuk munguan gjate fushates edhe veprimet per vonese ne daljen ne zgjedhje dhe per siglen me te cilen Partia Muslimane hyri ne keto zgjedhje parlamentare.

Disa te tjere u perpoqen te kontrollonin biografite e drejtuesve te Partise Muslimane, ne nje kohe qe biografite e ketyre "uritheve" jane te renduara nga sherbimet kunder muslimaneve. Pavaresisht nga shkopinjte nen rrota, u krijuan mundesite per te fituar perfaqesim ne parlament te Partise Muslimane permes nje votimi qe ne e quajtem te ndershem para se ai te fillonte. Por, votimet ne terren treguan se perse-ri ne Shqiperi, kur behen votime, "Peshku i madhe e ha peshkun e vogel" Me fakte konkrete eshte ver-

tetuar se votat e Partise Muslimane jane vjedhur ne qarkun e Shkodres. Ne nje kuti, ne Malesi te Madhe, u pohua se nuk ka nje vote te Partise Muslimane, ne nje kohe qe, pasi u rishikuan votat, aty ishin 27 vota te kesaj partie. Nuk mungojne edhe raste te tjera per te denoncuar keto veprime te pandershme qe u pasuan me vone edhe me grabitje votash ne shkalle kombetare ku shifrat arriten ne mijra. Pavaresisht se nuk iu mundesua perfaqesimi ne kete parlamen, Partia Muslimane i tregoi elektoratit te saj se ai nuk duhet te harroje identitetin e tij dhe se e ka obligim qe te kerkojne te drejtat qe i takojne dhe duhet t'i bejne nje barriere te hekurt islamofobise ne Shqiperi e cila tashme eshte bere pjese ehapur e islamobofise qe ka perfshire te gjithë boten, ku muslimanet po trajtohen si "delja e zeze", pas te ciles, sipas tyre, fshihet "mortaja e zeze" qe rrezikon shoqerine njerezore.

Selim GOKAJ

KONFERENCA E NATOS DHE HISTERIA ME ISLAMIN NE MC2

Në shtator të vitit 2006 OJQ-ja "Millenium Club Center" (MC2) e drejtuar nga Mentor Nazarko organizoi një konferencë me titull "*Strengthening Religious Tolerance for a Secure Civil Society in Albania and the Southern Balkans*". Kjo konferencë që në ditët e para të organizimit të saj shkaktoi një skandal në Shqipëri, pasi ish-presidenti i Republikës së Shqipërisë, Rexhep Mejdani, deklaroi se i mbështetur mbi disa enciklopedi fundamentalistësh të krishterë kishte mësuar që popullsia shqiptare e besimit musliman në Shqipëri është gjithsej 38.8 % për qind, ndërsa ajo kristiane është 35.4% për qind, duke e ndarë në 16.8 për qind katolikë dhe në 16.1 për qind ortodoksë. Ndaj kësaj deklarate dashakeqe reagoi Forumi Musliman i Shqipërisë i cili denoncoi përpjekjet e organizatave fundamentaliste evangjeliste si Qendra Kërkimore Botërore e Ungjillizimit, të cilat nxjerrin kësi statistikash jo-shkencore dhe duan të prishin balancat fetare në Shqipëri. Forumi Musliman këshilloi Rexhep Mejdani që të qëndrojë larg këtyre botimesh dashakëqia dhe jo serioze. Ndaj reagimit të Forumit Musliman reagoi një vit më vonë edhe historia katolike Ines Angeli Murzaku e cila në një shkrim të botuar në revistën RELIGION IN EASTERN EUROPE XXVIII, 1 (February 2008), mbron tezën e Mejdani dhe vë në pah se në Shqipëri tolerance fetare kërcënohet nga muslimanët të cilët pasi edukohen në botën muslimane, po sjellin një Islam arab në Shqipëri. Shkrimin e Ines Murzakut mua ma solli në vëmendje një historiane bullgare e cila ishte skandalizuar me nivelin e ulët akademik të autores, dhe më kërkoi që ti bëj edhe një replikë. Megjithatë si pasojë e detyrimeve të tjera që kam patur gjatë vitit të kaluar, unë vendosa ta injoroj incidentin e Mejdani dhe fantazitë e një katolikeje të rilindur si Murzaku e cila edhe në takimin e Tiranës, në vend që të fliste për tolerancën, prezantoi një punim mbi priftëritë italianë (të cilët ndryshe nga arabët që ajo i tregon si të këqinjë, italianët i tregonte si të mirë) dhe betejën e tyre kundër Islamit në Shqipëri.

Përpara disa ditësh, duke kërkuar në internet unë hasa aksidentalisht në librin "*Strengthening Religious Tolerance for a Secure Civil Society in Albania and the Southern Balkans*" edituar nga James Pettifer dhe Mentor Nazarko ku ishin botuar punimet e konferencës të Tiranës. Libri bënte goxha shtrenjtë. Ishte 150 EURO. Thua se në atë të ishin shkruar mrekullitë më të mëdha të shekullit të XXI. Libri ishte botuar

nga IOS Press në vazhden e botimeve të NATO-s për Shkencë për Paqe dhe Çështje të Sigurisë. Duke qënë se pas "zbulimit" të Rexhep Mejdani të statistikave të Islamit në Shqipëri qëndronte edhe NATO, e cila me tanke dhe me avionë sot është kthyer si Traktati i Varshavës në vitet 70të dhe po vret muslimanë nëpër malet e Afganistanit dhe tashmë po konfrontohet edhe me Rusinë dhe mund ta çojë botën në një katastrofë botërore, unë, si ndjekës kureshta i politikës ndërkombëtare që jam, bëra çmosin që ta lexoja dhe kuptojë se çfarë shkence kishin prezantuar emisarët e NATO-s në Konferencën e Tiranës në shtator 2006. Libri të cilin arrita ta posedoj dhe e kam përpara meje në këto momente është prej 138 faqesh. Ai është i ndarë i në katër kapituj; ku i pari flet për fetë në Shqipëri dhe historikun e tyre; i dyti për studime lokale; i treti për paralele matanë Ballkanit; dhe i katërti ka konkluzionet. Librin e kam lexuar në këto 3 ditët e fundit. Leximin e nisa pardje kur isha duke udhëtuar me tren nga Lugano e Zvicrës për në Itali, dhe e mbarova sot, ndërsa isha në spital të Firences, në Pronto Soccorso ku jam duke kryer disa vizita mjekësore.

Libri *Strengthening Religious Tolerance...* ka një titull magjepës. Ai flet për përforsimin e tolerancës fetare dhe krijimin e një shoqërie civile të sigurtë në Shqipëri dhe Ballkanin jugor. Megjithatë toleranca fetare dhe saktësia shkencore është ajo që librit i mungon në shumicën e materialeve të tij. Libri hapet me një mesazh urimi nga senator Giulio Andreotti i cili pasi kërkon të falur që nuk ka mundur të vijë në Tiranë, thotë që është duke iu lutur Nënë Terezës që ti ndihmojë. Ama senator Andreotti mua si një lexues musliman dhe shqiptar të këtij libri më lë pak në dyshim mbi lutjen e senatorit. Për çfarë i lutet Andreotti Nënë Terezës dhe cilës Nënë Terezë i lutet ai? Asaj që Dr. Aroup Chaterjee tregon, apo asaj që po përdoret në Shqipëri për të katolicizuar identitetin e popullit shqiptar? Gjithësesi unë them inshallah Andreotti nuk i lutet Nënë Terezës që të realizohen mesazhet ogurzeza që libri që unë kam përpara ndjell për tolerancën fetare në Shqipëri. Pas lutjes së Andreotit libri i rrëfen lexuesit listën e pjesëmarrësve në konferencë. Në listë dikush lexon emra që variojnë që nga Peshkopi Anastas Janollatos, te famëkeqët Ilir Kulla, Sabri Godo, Rexhep Mejdani dhe Arben Xhaferri. Megjithatë mua emri që më tërhoqi më shumë vëmendje ishte ai i Ermir Gjinishit. Ermiri Gjinishi i cili mesa duket ka qënë i vetmi përfaqësues jo-zyrtar i muslimanëve shqiptarë në

këtë takim, paraqitet si ish-asistent kryetar i Komunitetit Musliman të Shqipërisë. Ky emri asistent-kryetar mua më konfuzoi pak, pasi unë nuk di që Gjinishi të ketë pasur ndonjë post të këtillë në jetën e tij. Megjithatë, në krahasim me mrekullitë e tjera të librit, ky indikacion nuk është edhe aq mbresëlënës.

Pas listës së pjesëmarrësve, libri vijon me një hyrje nga historiani britanik James Pettifer. Jamesi i cili mesa duket do të ketë qënë i kënaqur me sulmin e Rexhep Mejdani kundër mazhorancës muslimane në Shqipëri, paralajmëron lexuesin se Shqipëria edhe pse shihet si një vend me shumicë muslimane, nuk është më e këtillë, pasi në vend ka bashkësi të fuqishme dhe në rritje të krishterësh ortodoksë, katolikë dhe evangjelistë. Pas kësaj libri vijon me një fjalim të Sabri Godos. Në fjalimin e Sabriut bie në sy rrëfimi që ai i bën botës së sotme e cila sipas tij po përballet me "rrezikun e përhapjes së errësirës" dhe dukuritë e përhapjes së Islamit radikal në Maqedoni dhe në disa xhepa të Kosovës. Si për ti ardhur pas fillit James Pettiferit dhe Rexhepit, Sabriu i mburret pjesëmarrësve në konferencë me shembullin e vetes së tij, që edhe pse vjen nga një familje synite, vajzën e tij të madhe e ka martuar me djalin e një prifti ortodoks, ndërsa burri i vajzës së dytë ishte gjysëm katolik e gjysëm ortodoks. Si për ti treguar pjesëmarrësve që në Shqipëri nuk ka më Islam, Godo vë në pah që familjet mikse janë në rritje të vazhdueshme dhe konkluzioni që dikush nxjerr është që në Shqipëri nuk do të ketë më fe monolite. Enver Hoxha do ta kishte patur zili fjalimin e Godos; por medoemos do ketë patur edhe më zili fjalimin hapës të Rexhep Mejdani që gjejmë në faqen 3. Në librin që unë kam përpara, Mejdani është kujdesur që të heqë referencat e tija mbi përqindjet fetare në Shqipëri me të cilat bëri bujë në 2006. Por këtu ai falenderon programin e NATO-s për Shkencë për Paqe dhe Çështje të Sigurisë që i ka dhënë para Mejdani dhe Mentor Nazarkos që të organizojë konferencën, dhe i tregon pjesëmarrësve se ëndra e tij ka qënë të shohë një fe universale në botë; të mposhtë armikun shekullor i cili është paragjykimi fetar dhe në fund i siguron pjesëmarrësit se në konferencë janë zgjedhur me kujdes disa klerikë, politikanë dhe akademikë të cilët do ti sjellin konferencës sukses. Ndërsa shoh që nga Kisha Katolike, Ortodokse dhe Protestante kanë ardhur disa reverendë goxha të zgjuar dhe të zotë, dhe kur shoh që Mejdani dhe kompani nuk ka ftuar asnjë njeri me taban nga Komuniteti Musliman dhe Bekta-

shian, bindem që Mejdani ka të drejtë kur mendon që konferenca do të ketë sukses.

Fjalimi i Mejdani ndiqet nga një punim i Gjergj Sinanit mbi Kanunin dhe Kishën Katolike, ku Sinani i siguron pjesëmarrësit se Shqipëria trashëgon një tolerancë fetare që nga antikiteti e deri në mesjetë, e cila u ruajt edhe pas përhapjes së Islamit dhe se Shqipëria nuk njeh viktimë të intolerancës fetare, por vetëm viktimë të kishave fqinje. Kur dikush lexon konkluzionet e Sinanit ku fajn e intolerancës e marrin vetëm të huajt, lexuesi mund të pyes po nga viti 1945 e deri në 1991, apo nga 1997 e deri më sot, çfarë ka ndodhur në Shqipëri me ata mijëra hoxhallarët dhe priftërinjë, besimtarë dhe besimtare që janë vlarë e persekutuar nga armata e sigurimit të shtetit, dhe që sot dëbohen nga shkollat pse mbajnë shami apo mjekra? A nuk janë viktimë të persekutimit fetar nga vetë shqiptarët këta njerëz apo ndoshta i përkasin një planeti tjetër? Si për të vërtetuarën të kundërtën e punimit të Sinanit, shkrimi i tij ndiqet nga një shkrim i Mentor Nazarkos drejtuesit të Millenium Club Center. Në një punim që i shkon për shtat vetëm një sigurimi të shtetit monist të kohës së Partisë së Punës dhe të duket sikur e ka shkruar Xhavit Shala, Fatos Klosi apo Irakli Koçollari, Nazarko i tregon pjesëmarrësve se në Shqipëri disa grupe ekstreme dhe intolerante kanë nisur të kenë influencë mbi rininë. Ai këshillon se nëse ndaj këtyre trendeve që kanë nisur të shfaqen nuk merren masa serioze, ata do të bëhen kërcënim serioz jo vetëm për vendin, por edhe për rajonin. Sipas Nazarkos problemet fetare në Shqipëri vinë si pasojë e mungesës së kontrollit qeveritar. Megjithatë ai tregon që disa organizata (lexo islame) kanë patur punëtorët e tyre të dëbuar forcërisht në Egjipt. Nazarko sjell shembullin e Jasin Kadisë, të cilin ai e ngatërron me Abdyl Latif Salehun, shokun e ngushtë të shokut të tij presidentit Mejdani (të cilin Abdylatifi e mbushte me dhurata) dhe e bën të parin edhe drejtor të organizatës al-Haramain. Me shqetësim ai vë në dukje se shteti deri më tani njeh vetëm 20 organizata islamike, ndërsa të tjerat veprojnë nën rrogë; se në vend ka 431 xhami por 203 janë jashtë kontrollit të Komunitetit Musliman; se pas futjes së Shqipërisë në Islamic World Organization (sic!) mijëra të rinjë shqiptarë janë rekrutuar dhe dërguar të studiojnë në vende të ndryshme arabe; se numri i këtyre nuk dihet dhe se shqiptarët që kanë shkruar të studiojnë në vendet e njohura islamike me orientim të ashpër nuk duhen injoruar. Më tej autori

tregon që intelijenca e re muslimane ndjehet e irrituar pse lihet jashtë shoqërisë; se ekziston një konflikt në rangjet e larta të Komunitetit Musliman në lidhje me manaxhimin e pronave etj. Një nga solucionet që Nazarko propozon për tu marrë me Islamin dhe muslimanët është spiunimi i tyre, mbajtja shënimi e aktiviteteve të tyre dhe mbështetje teknike dhe institucionale për të kryer këtë punë.

Shkrimi i Nazarkos ndiqet nga shkrimi i Rexhep Mejdanit, shokut të ngushtë të Nazarkos dhe Abdyl Latif Salehut – të cilin amerikanët e dëbuan nga Shqipëria në fundvitet 90të. Në shkrimin e tij, Mejdani flet për “modelin shqiptar” ku sipas tij identiteti kombëtar i shqiptarëve është ndër-tuar mbi tolerancë të përbashkët dhe traditën. Mejdani tolerancën e shqiptarëve e shtrin që në antikitetet me ilirët, arbërit, dmth shqiptarët (autori duke se ka harruar të fusë në këtë listë darviniste evolucioni edhe pararendësit e ilirëve, majmunët) të cilët janë munduar gjithnjë të harmonizojnë efektet që vinë nga jashtë vendit. Ai i tregon ilirët e lashtë aq gjenialë sa që ata i dhanë krishtërimin disa formula pagane në mënyrë që të ruajnë traditat e tyre dhe kur krishtërimi u nda në dy pjesë, ilirët u munduan të ndërtojnë ura komunikimi ndërmjet të dy feve. Progresi i tolerancës shqiptare sipas autoriti dhe vigjëlencia e tyre vazhdon edhe në kohën e Islamit, kur Muhammed Ali Pasha ndërtoi një Egjipt me standarte perëndimore, Pashko Vasa themeloi një Liban shumë-fetar; dhe kjo linjë teleologjike vazhdon për shqiptarët deri më sot, ku, sipas autorit, Nënë Tereza konsiderohet si nënë e madhe e të gjithë shqiptarëve, pa marrë parasysh fenë e tyre.

Por një nga punimet më fantastikë të konferencës është ai i Miranda Vickersit. Miranda Vickers e cila është bërë e famshme tashmë me muslimanët shqiptarë dhe paditurinë e saj mbi Islamin në Shqipëri morri një replikë zyrtare nga Forumi Musliman i Shqipërisë më datë 13 nëntor 2008, të cilës ajo deri më tani ka dështuar ti përgjigjet. Gjithësesi, në shkrimin e saj “Zhvillimi i feve në Shqipërinë pas-komuniste” autorja në vend që të merret me të gjitha besimet dhe mosbesimet e Shqipërisë, merret pak me Ortodoksinë dhe pothuajse totalisht me Islamin; duke harruar në mënyrë totale Katoliçizmin. Punimi i Mirandës nis me një presupozim fantastik të cilin në Shqipëri e deklaronte rëndom Enver Hoxha dhe sot unë di ta deklarojë vetëm Petrika Thëngjilli. Sipas saj, shqiptarët i kanë ndërruar fetë sipas interesit. Por duke përsëritur tezat e komunizmit mbi Islamin, islamizimin e shqiptarëve ajo e shpjegon si pasojë e politikave të Portës së Lartë e cila gjatë shekullit të 18të rriti taksat mbi jo-muslimanët dhe rriti favorin me muslimanët, gjë që çoi në konvertimin masiv të shqiptarëve në Islam. Autorja përsërit këtu klishtë e Kishës Katolike dhe deklaroi se ndërsa burrat u islamizuan (nga frika e turkut), gratë qëndruan burrëresha dhe kau-

resha. Pas përsëritjes së legjendave të komunizmit mbi islamizimin e shqiptarëve, Vickers flet edhe për situatën e sotme të Islamit në vendin tonë. Këtu ajo përsërit tezat e hedhura nga Ilir Kulla, Piro Misha dhe sigurimi i shtetit gjatë kohës së sundimit ortodoks të Fatos Nanos, ku sipas saj në gjirin e Islamit shqiptar ekziston një konflikt ndërmjet të rinjve që janë mbështetës të shkollës radikale Selefiste dhe të vjetërve që janë mbështetës të shkollës Hanefite. Përndryshe nga ç’predikojnë ekspertët bushistë nëpër perëndim, ku synitet zakonisht tregohen si të këqijtë e Al-Kaedës ndërsa shiitët si të këqijtë e Iranit; Vickersi tregon që në Shqipëri kanë ekzistuar dy forma Islami të moderuar; synitet dhe bektashianët. Por kjo nuk është e gjitha. Si kudo në botë, që nga Iraku e deri në Afganistan edhe në Shqipëri, Vickersi ndërton një konflikt fantastik në shkrimin e saj. Ajo tregon që dy shkollat “e mira” të Islamit shqiptar po kërcënohen nga “të rinjtë” që po kthehen nga shkollat e institucioneve islamike “jashtë vendit”. Sipas saj selefijtë që vinë nga jashtë Shqipërisë, tamam si muxhahedinët e al-Kaedës në Irak, kanë konsoliduar kontrollin në xhamitë e vendit dhe Tiranës. Kur në një njeri i paditur me Shqipërinë lexon shkrimin e Vickersit krijon padyshim imazhin në mendjen e tij se Tirana ndodhet diku “next to Kandahar” dhe këta selefijtë portretizohen si ca mullenjë talebanë me mitraloza dhe dykëmbështa, të cilët autorja i tregon sikur janë rreshtuar për xhihad kundër tolerancës së Kauristanit të xhamia e Dine Hoxhës dhe Etheme Beut. Mama mia!

Histeria e Miranda Vickersit me muslimanët shqiptarë vazhdon edhe mandej. Ajo tregon sesi kur një grua viziton xhamitë e Tiranës ajo pritet me shikime me sytë poshtë dhe dinakë të të rinjve. Xhamitë e Pazarit të Ri dhe Dine Hoxhës tregohen si të mbushura me një atmosferë dyshuese për të huajt. Vickers vë në pah që vizitorët ndjehen më pak të mirëpritur nga djemtë e rinjë që tanimë janë kthyer nga Arabia Saudite dhe Jemeni të cilët nuk kanë qejf të ulen dhe bisedojnë me të huajt, siç ka qenë tradita më parë. Të rinjtë që vinë nga jashtë jo vetëm që kanë shkaktuar përçarje në Komunitetin Musliman, por perceptohen edhe si ‘terroristë potencialë’. Unë nuk e di nëse ndonjë djalë i ri e ka rrahur me sheriat Miranda Vickersin në ndonjë xhami të Tiranës dhe i ka vendosur ferexhenë në kokë, por shkrimi i autores mua më bën të më çohet mishi përpjetë nga frika. Gjithësesi për njerëzit zemërbutë si puna ime, konkluzioni i autores është triumfues. Ajo tregon se si pasojë e monitorimit të ashpër të organizatave islamike në vend, radikalët kanë gjetur shumë vështirësi të operojnë. Kohët e fundit, radikalët, dmth të rinjtë – selefijnë, janë mundur nga të moderuarit dmth pleqtë, të cilët ruajtën medhhebin Hanefi nga radikali Selefi. Në konkluzion, Vickersi konkludon

se duke qenë se në Shqipëri ka shumë xhamira, pra 431 copë, dhe organizata islamike që operojnë jashtë kontrollit të Komunitetit Musliman, vlerat tradicionale muslimane janë në rrezik si pasojë e influencave të huaja.

Fantazitë e Miranda Vickersit ndiqen në libër nga një seri shkrimesh të tjera, të shkruara me një anglishte të dobët dhe plot gabime të cilat nuk po marr mundimin ti komentoj. Por në pjesën e dytë të librit, lexuesi kënaqet kur sheh që shkrimi i parë i këtij seksioni fillon me një shkrim patriotik nga “ish-asistent kryetari i Komunitetit Musliman” Ermir Gjinishi; një person për të cilin mediat kanë shkruar shumë, por që në këtë konferencë përfaqëson muslimanët e Shqipërisë. Në punimin e tij autori është munduar të japë një background të historisë së Komunitetit Musliman nga viti 1912 në 1920. Gjinishi, i cili në faqen 29 të librit tregohet nga Miranda Vickersi si drejtues i krahut radikal dhe anti-modernist të selefijve, që normalisht, sipas përshkrimit të Vickersit duhet të ishte një mulla me turban që në sallë duhet të bërtiste Allahu Ekber dhe ti vinte ferexhenë kaureshës nga Ingilizistani, në faqen 57 e tregon veten si heroin e patriotizmit shqiptar. Është një gallatë të cilën studiuesi hungarez Gyorgy Lederer në shkrimin “Islamists and public security concerns in eastern Europe” e ka përshkruar si rezultat i terrorit të policisë shqiptare për të ju përgjigjur pritshmërive amerikane – të cilat kanë detyruar edhe selefistët ndërkombëtarë që të sillen si patriotë krenarë. Dhe ky patriotizëm lexohet qartë në shkrimin e Gjinishit, i cili nacionalizmin pafe shqiptar e shtrin që nga Lidhja e Prizrenit, dhe e deklaroi me krenari si të finalizuar në vitin 1923 kur Komuniteti Musliman u nda me dhunë nga Kalifati dhe muslimanët shqiptarë nisën të ç’islamizohen dhe ti falen zotit të nacionalizmit. Por tolerancën dhe bashkëekzistencën e feve në Shqipëri, Gjinishi e shpjegon si një armë (unë do thoja tamam si lufta “më pushkë dhe me penë” e kohës së rilindjes) që patriotët shqiptarë përdorën kundër pushtuesit Turk, Grek dhe Serb. Më pas, kur flet për situatën aktuale të Islamit në vend, Gjinishi, ashtu si Ilir Kulla disa vite më parë, tregon sesi Komuniteti Musliman ka refuzuar ndihmën e të huajve për të ruajtur ‘kornizat teologjike kombëtare’; ka forcuar hanefizmin si mburojë kundër influencave të huaja etj. Ai vë në pah që donacionet e dyshimta që janë bërë nga të huajt në Shqipëri kanë krijuar marrëdhënie antagoniste ndërmjet “Islamit shqiptar” dhe “Islamit arab.” Për më tepër dërgimi jashtë vendit dhe pa lejen e Komunitetit Musliman të studentëve ka sjellë në Shqipëri eksportimin e medhhebit Hanbeli. Megjithatë për Gjinishin, muslimanët në Shqipëri janë jopolitikë dhe të bindur. Ata nuk mërzhiten pse në vend ekziston një Parti e Krishterë. Muslimanët vetë nuk duan parti islamike. Ai kujton që qeveria shqiptare duhet të për-

fundojë masat ligjore për të ndaluar hyrjen në vend të ideologjive militariste dhe fetarisht të deformuara që ekzistojnë në Egjipt dhe Pakistan dhe vë në pah që ndodhitë e 11 shtatorit janë dënuar në mënyrë ekuivoke, në të gjithë xhamitë e Shqipërisë duke shpëtuar kështu vendin nga infeksioni i ideologjive fetare. Si përfundim, Gjinishi konkludon që muslimanëve shqiptarë nuk i kanë bërë përshtypje si muslimanëve të tjerë jashtë vendit, as karikaturat kundër Profetit dhe as ofendimet e Papës kundër Islamit, pasi muslimanët shqiptarë janë të moderuar dhe kanë konsoliduar traditën e paqes në Shqipëri. Kur dikush lexon shkrimin e Vickersit ku Gjinishi tregohet taliban dhe të Gjinishit i cili tregohet më kaur se Papa dhe më patriot sesa vetë rilindasit e lashtë dhe modernë lexuesi pyet veten; ore po armiku cili është këtu?

Një shkrim tjetër që merret me Islamin në librin në fjalë, është edhe shkrimi i Arben Xhaferrit, me titull “Ndalimi fetar i shenjtës”. Në këtë shkrim, Xhaferri e nis rrëfimin e tij me një kompleks inferioriteti ndaj perëndimit. Ai citon një citim nga Farid Zakaria ku një politikan indian pyet kryeministrin Indira Gandhi përse hindutë kanë tendencën të zhvillohen më shumë nën sundimin e të huajve sesa në të tyren? Çështja që Xhaferri kërkon të vëjë në pah, është se vendet që kanë kulturë perëndimore kanë më shumë shanse të përparojnë sesa ato që janë me kulturë lindore. Kompleksin e tij indian, Xhaferri kërkon ta transportojë te Islami, i cili nuk është shekullarizuar ende si krishtërimi perëndimor. Ai lavdëron Atatürkun i cili ndryshoi kulturën turke nga ‘a la turka’ në ‘a la franka’, zhveshi klerikët muslimanë nga veshja e tyre fetare, ndërsa priftërijtë e krishterë i la të paprekur. Ashtu si edhe shumë shkrime të tjera në këtë libër të paedituar gjuhësisht dhe shkencërisht, shkrimi i Xhaferrit ka shumë gabime. Autori duket të humbasë si Xhaferri simiten shkronja në tekst kur psh. Bosforin e quan Fosfor, apo fjalën Fetva e përkthen akuzim, mallkim, dhe fajëson Islamin për mospranimin e demokracisë. Ndërsa nuk do të shohë historinë e gjatë të imperializmit dhe tiranive të instaluar nga krishtërimi dhe perëndimi në Lindjen e Mesme, Xhaferri jo vetëm që rri duke akuzuar Islamin si fajtor për moszhvillimin e muslimanëve, por tregon edhe shqetësimin e tij pse në botën arabe nuk ka politike mbi baza etnike. Sipas tij faj këtu ka mentaliteti lindor i cili është ekskluzivist, ndërsa ai perëndimor është gjithëpërfshirës, tolerant dhe kozmopolit. Urrejtja që Arben Xhaferri ka për Islamin, ia err sytë aq shumë sa që ai pretendon që në vendet perëndimore muslimanët tolerohen nga perëndimi që të ndërtojnë xhami, por në Lindje, në Arabinë Saudite, ndërtimi i objekteve të krishtera nuk tolerohet. Si duket Xhaferri në Tetovën ku jeton, nuk arrin të shohi dot as RAI 1, as BBC-në, as Al Jazeera dhe as të lexojë Corrie-

re Della Seran që të mund të krahasojë diktaturën amerikane të Arabisë Saudite me Italinë e Veriut fjalla bie, ku muslimanët, jo vetëm që Lega Nord nuk i lejon të ndërtojnë xhami, por nuk i lë që të falen as në rrugë apo të veshin gratë e tyre më ferexhe. Por padyshim Arben Xhaferrit nuk ka qejf ti përmendë këto fakte, dhe as ti kujtojë lexuesëve që në Greqi, që nga koha e Ali Pashë Tepelenës, xhamitë shqiptare qëndrojnë ende të mbyllura; pse Xhaferrit dhe partisë së tij i duhet mbështetja greke për të qëndruar në pushtet mbi muslimanët e Maqedonisë që ky i urren kaq shumë. Por budallallëqet e Xhaferrit nuk lidhen vetëm me punën e xhamive. Në faqen 89 të librit ai shfryn inatin e tij edhe me Perandorinë Osmane kur gënjen dhe thotë që vetëm të krishterët kishin të drejtën e milletit në këtë Perandori, ndërsa muslimanët jo. Thelbi i shkrimit të Xhaferrit e tregon Islamit si një fe totalitariste, muslimanët si njerëz utopikë që duan të ndërtojnë xhenetin në tokë, dhe besimin në Kuran dhe në ymet e tregon si një formë ideologjike totalitare. Sipas tij, Islami duhet të ndjekë shembullin e krishtërit dhe të shekullarizohet. Përndryshe ai konkludon se për sa kohë që fetë nuk ndalojnë të shenjtën (e cila për atë është largimi i Zotit nga jeta e njeriut), azani i muezinit duhet të shihet jo si një thirrje për të ju lutur Zotit, por si një deklaratë për luftë.

Shkrimi militant i Arben Xhaferrit ndiqet nga shkrimi i Erica Chenouethit, lektore në Universitetin Metodit të Uesleyanit me titull "Efektet e paparashikuara të demokratizimit mbi grupet ekstreme fetare". Erica e cila nëse dikush lexon CV-në e saj në faqen e Universitetit të Uesleyanit, kuptohet lehtë që është bushiste e thekur që beson në luftën globale ndërmjet 'të mirës dhe të keqes', në konferencë duket se ka luajtur rolin e Cinderrellës – apo Hirushes. Ajo profetizon që në Shqipëri procesi i demokratizimit do të sjellë medoemos grupe terroriste që do të përdorin dhunë dhe kjo dhunë mund të ketë natyrë fetare. Megjithatë, shqetësimi i Ericës nuk është se nga do të vijë ky terrorizëm, por si një emisare e lartë e Bushizmit, ajo këshillon qeverinë shqiptare mbi masat që duhet të marrë për tu përballur me grupet radikale. Vendet si Shqipëria duhet të shohin shembullin e Irakut dhe Palestinës, ku demokratizimi ka prodhuar radikalë; dhe mesa kuptohet Erica duke se favorizon kufizimin e lirive demokratike në vend, për të mos i lënë radikalët të drejtën që të ankohen mbi krimet që shteti mund të kryejë mbi ata. Erica Chenoueth që ka përgatitur edhe konkluzionet e kësaj konference për Grupin e Kërkimeve të Përparuara të NATO-s, konkludon në faqen 133 se në Shqipëri, Vahabizmi dhe Arabia Saudite mund të mundohen që të ndërtojnë xhami dhe shkolla radikale. Rinia e edukuar në botën islame mund të prishë bashkëekzistencën e viteve të mëparshme. Por për të ruajtur vendin nga një gjë e këfillë, duhet të ruhet autonomia e institucioneve fetare shqiptare; Shqipëria duhet të ndërtojë një universitet të saj teologjik për të mos i lënë muslimanët që të shkollohen në botën islame. Ajo konkludon gjithashtu se Shqipëria është shumë e kërcënuar nga terrorizmi. Për këtë, qeveria duhet të mbështesë të moderuarit dhe nëse akte terroriste ndodhin, qeveria duhet të përdorë masa shtypëse kundër tyre. Për të luftuar radikalët duhet të përdoren mediat të cilat duhet të promovojnë të moderuarit, dhe të mbështeten OJQ-të të cilat mbikqyrin radikalët.

Përveç demonizimit të Islamit, konferenca *Strengthening Religious Tolerance...* pati pjesëmarrës edhe nga komunitete të tjera fetare të Shqipërisë dhe historianë seriozë. Asistenti peshkopi i Kishës Katolike në Tiranë George Frenco në fjalimin e tij "Fetë dhe toleranca fetare" mundohet ti përdikojë të pranishmëve mbi vlerat që Krishtërimi ka për shoqëritë pe-

rëndimore dhe stagnacionin e shekullarizmit. Peshkopi grek, Anastas Janollatos në fjalimin "Drejt një paqeje të vazhdueshme dhe bashkëekzistencës në Ballkan" flet për vlerat që Kisha duhet ti japë shoqërisë. Janullatosi sulmon me të drejtë nacionalizmat ballkanik dhe ateistët, ku ai ka padyshim organizatorët e konferencës, të cilët, sot, hiqen sikur mbështesin fetë tradicionale në mënyrë që të mbrojnë interesat e tyre kombëtariste. Ndërsa i deleguari i qeverisë italiane, Sheikh Abd al-Vahab Pallavicini në fjalimin "E vërteta dhe diversiteti pas qëllimeve të përbashkëta" mundohet të tregojë rrugën e përbashkët të Judaizmit, Krishtërit dhe Islamit si fe monoteiste, ndërsa shan Islamit si fe e cila vuan ende sot nga inkuizicioni dhe solucioni sipas tij është Sufizmi. Ish-muslimani i konvertuar në protestant, Fitar Muça në shkrimin "Trashëgimia e evangjelistëve shqiptarë dhe vazhdimi në vitet pas-1990" ka bërë një rezymë të historisë së protestantizmit në Shqipëri; me vllahët Sevasti, Parashqevi dhe Gjerashim Qiriazhi, Kostandin Kristoforidhi dhe Petro Nini Luarasi. Ai tregon sesi sot në Shqipëri ekzistojnë 120 kisha protestante dhe vë në dukje aktivitetet humanitare të kishës. Shkrimi i fundit i konferencës që merret me Krishtërimin në Shqipëri është ai i Ines Angjeli Murzakut me titull "Ndërmjet lindjes dhe perëndimit: priftërijtë bazilianë të Grottaferratës në Shqipëri". Murzaku këtu tregon sesi turqit me ardhjen e tyre në Ballkan "zhdukën shtetet shqiptare, bullgare, romane dhe serbe" (sic!). Dhe në këtë vazhdë pushtimi, autorja tregon sesi shqiptarët trima i rezistuan heroikisht turqve me në krye Skënderbeun dhe më pas, në vend që ti shërbenin sulltanit osman, disa mijëra prej tyre u larguan drejt Italisë. Autorja merret me pas me misionin e priftërijve bazilianë në shërbim të unitetit të krishterë; dhe aktivitetet e tyre në Shqipërinë e shekullit të XX në shërbim të Kishës Katolike. Pasi lavdëron bëmat e Kishës Katolike dhe Ortodokse në shërbim të refugjatëve kosovarë, Murzaku e krahason ndihmën e Kishës me shpirtin e Nënë Terezës, për të cilën, shqiptarët qoftë ata edhe muslimanë duhet të jenë krenarë.

Libri *Strengthening Religious Tolerance...* mbyllet me fjalimin e vajzës së Rexhep Mejdani, Adea Mejdani me titull "Dialogu ndër-fetar". Adea rrëfen që shembulli shqiptar i tolerancës është shumë i rëndësishëm. Por ajo thekson se opinioni i shumë juristëve të huaj është se në disa drejtime bazat ligjore të Shqipërisë që merren me minoritetet dhe fenë, mbajnë shumë klauzola demokratike të cilat nuk gjenden jo vetëm në ish-vendet komuniste por edhe në vendet e zhvilluara demokratike. Por sipas Adeas shqiptarët jo vetëm që pranojnë dhe respektojnë fetë e ndryshme, ashtu siç bëjnë të gjithë vendet perëndimore, por fëmijtë e familjeve mikse mund të zgjedhin fenë që ata dëshirojnë. Adea tregon që ajo vetë është një nga këta shembuj. Këtu Adea si duket ka parasysh që babai i saj, rrjedh nga një familje muslimanësh; por që më pas u bë qafir dhe enverist dhe ka qenë një nga shkatërruesit e xhamive në Shqipëri në vitin 1967, ndërsa e bija është vafitur në të krishterë. Pasi dikush lexon shkrimet e kësaj konference dhe ka parasysh intolerancën fetare që Rexhep Mejdani provokoi në Shqipëri në vitin 2006; një lexuesi të paanshëm i mbushet mendja top që konferenca "Strengthening Religious Tolerance for a Secure Civil Society in Albania and the Southern Balkans" vetëm për tolerancë nuk ka folur. Në këtë konferencë që nga faqja e parë dhe deri në të fundit të librit ne lexojmë të krishterë që i luten Nënë Terezës dhe lavdërojnë Krishtërimin; lexojmë disa burra me emra muslimanë si Rexhep, Xhaferr, Sabri e Mentor që shajnë Islamit dhe i thonë të ftuarve nga Perëndimi i Krishterë që ata nuk janë më muslimanë por janë bërë laramanë si pasojë e hibridizimit me të krishterët; dhe një ish-pal-asistent të KMSH-së i cili i ka bërë amin axhendës

dhe selektimit të kujdesshëm që Rexhep Mejdani i ka bërë pjesëmarrësve në këtë konferencë. Në këtë konferencë, Islami, muslimanët shqiptarë jo vetëm që nuk janë prezantuar si duhet; por kjo konferencë duket që ka qenë një monolog të krishterësh dhe ateistësh ku muslimanët e Shqipërisë dhe Islami janë keqprezantuar, ofenduar dhe ndaj tyre është kërkuar që të ushtrohet aparteid shtetëror.

Shkruesit të këtij shkrimi, mërzia më e madhe i vjen nga fakti që një konferencë e këfillë është sponsorizuar nga një aleancë ushtarake siç është NATO, dhe programi i saj për Shkencë për Paqe dhe Çështje të Sigurisë. NATO e cila posedon avionë, tanke dhe armë bërthamore me të cilat sot ka bërë zap gjysmën e botës, nuk duhet ta uli veten kaq poshtë, sa që të sponsorizojë disa njerëz të cilët në historinë e Shqipërisë kanë shkatërruar kishat dhe xhamitë dhe kanë brohoritur për Enver Hoxhën dhe Traktatin e Varshavës dhe mallkuar armatën e imperializmit amerikan; NATO-n. Unë e kuptoj që në kohën kur kjo konferencë është mbajtur në Tiranë, NATO sundohej ende nga mendimet agresive të presidentit Bush i cili zhyti Perëndimin dhe botën islame në gjak dhe luftë. Megjithatë me zgjedhjen e presidentit Barack Obama në krye të SHBA-ve në vitin 2009 unë shpresoj që NATO do të ndryshojë kursin e saj ndaj muslimanëve dhe të mos silltet më si një klub cubash të krishterë, pasi pjesë e NATO-s në fund të fundit është edhe Turqia një nga vendet më të rëndësishme të botës muslimane sot. Siç edhe analisti amerikan Zbigniew Brzezinski ka deklaruar gjatë fushatës në mbështetje të presidentit Obama, Islami nuk është armik i Perëndimit dhe Perëndimi nuk ka nevojë të armiqësojë muslimanët sipas fantazive të evangjelistëve dhe fundamentalistëve të krishterë të cilët lulëzuan në kohën e presidentit Bush në Perëndim. Për mendimin tim, sponsorizimi i konferencës dhe librit "*Strengthening Religious Tolerance for a Secure Civil Society in Albania and the Southern Balkans*" nga programi i NATO-s për Shkencë për Paqe dhe Çështje të Sigurisë është një turp i kësaj organizate e cila ka fyer me shkrimet e prezantuar dhe botuara, ndjesitë e muslimanëve shqiptarë të Kosovës, Shqipërisë dhe Maqedonisë. Zotërijtë që drejtojnë NATO-n sot e dinë fare mirë që muslimanët shqiptarë nuk kanë as fonde dhe as fuqi që të kundërshtojnë konferencat e NATO-s ku feja e tyre poshtërohet dhe nuk kanë as akademi që ti përgjigjen të gjitha budallëqeve që janë prezantuar aty. Zotërijtë që sot drejtojnë NATO-n e dinë shumë mirë se çfarë kanë hequr muslimanët shqiptarë nga Rexhepët, Sabrijtë dhe arma e egër e sigurimit të shtetit në kohën e komunizmit por edhe pas vitit 1998 kur fondacionet, xhamitë, shkollat e medresetë e tyre janë mbyllur, ndërsa të krishterët kanë arritur të shtrihen kudo dhe me mbështetjen e Perëndimit të prozelitojnë disa mijëra shqiptarë drejt Krishtërit. Megjithatë, zotërijtë që drejtojnë NATO-n sot duhet ta dinë që muslimanët e persekutuar shqiptarë ashtu si edhe Jezu Krishti kur qëndronte në kryq përballë ushtarëve romakë, posedojnë ushtritë e padukshme të moralit dhe shpresës në Allahun, Zotin e qiejve dhe të tokës i cili triumfon mbi çdo perandori dhe superfuqi. Do të ishte e udhës që zotërijtë që drejtojnë NATO-n sot të mos sponsorizojnë në të ardhmen programe të këtilla të kota që ofendojnë muslimanët shqiptarë. NATO duhet të silltet si një organizatë shekullare që mbron sigurinë në botë dhe jo si një klub cubash të krishterë që nxit intolerancë kundër Islamit dhe muslimanëve. Nëse krijohet mundësia, zyrat e NATO-s që janë në Tiranë duhet të marrin hapa konkretë dhe të shërojnë plagët që kjo konferencë i ka shkaktuar muslimanëve të Shqipërisë, Kosovës dhe Maqedonisë.

RADIO JEHONA JEHON ME SUKSES NE QYTETIN E SHKODRES

Kane kaluar vetem pak dite, kur radio me e re ne qyteten e Shkodres, "Radio Jehona" ka emetuar ne valet e saj per ndegjuesit shkodrane dhe me gjere programet e saj te para modeste per te vazhduar me pas me programe me te plota dhe me te larmishme te cilat do te jene nje dritare e vecante, ku ndegjesit e saj do te kene rastin te shijojne programacione qe do te jene larg klisheve tashme te njohura radiofonike, ku ushtojne dhe gje-mojne tinguj marramendes qe te "raskapisin" te cilet percojne mesazhe, ku normat e moralit dhe ato te edukimit zene vendin e fundit, pa harruar edhe nihilizmin me te cilin trajtohet muzika popullore dhe ajo e tradites, duke bere qe per ndigjuesin, sidomos te rinjte, qe ajo e cila eshte shqiptare te shikohet si jo e dites dhe jo "moderne" Misioni i kesaj radio te re eshte qe, permes programeve te saj, te tregojte respek dhe seriozitet ndaj ndegjuesve, ndaj vlerave aktuale dhe te trasheguara te qytetet te Shkodres dhe mbi te gjitha "Radio Jehona" do te jete nje ze i sinqerte dhe i fuqishem per te percjelle mesazhin e dashurise dhe te respektit ne mes te qytetareve shkodrane dhe te te gjitha shqiptareve, pa harruar se

ky mesazh do te rrezatoje edhe tek te gjitha njerezit ne pergjithesi. E formuar ne vitin 2008 nga nje grup intelektualesh shkodrane, "Radio Jehona" ka ambicje per te punuar dhe per te qene radio me e ndegjuar ne te gjitha Veriun e Shqiperise gje qe do te arrihet duke i shtrire valet e saj edhe ne trojet shqiptare per-tej Shqiperise Londineze si: Tuz, Ulqin, Kraje me synimin per t'i kapercyer keto hapesira, duke respektuar kurdohere hapesiren e vleve te saj te percaktuar ne licensen sipas te ciles operon sot "Radio Jehona". Duke kalkuluar me vertetesi interesimin me te cilin sot po ndiqet kjo media, ne mund te themi se ndigjuesit e saj me siguri do te arrijne shifren 600 mije, duke treguar se ajo ka qene e mirepritur nga ndegjuesit, sepse eshte fakt qe nje portret mediatik "tip Jehona" i ka munguar ndegjuesit shkodrane si ne drejtim te tematikes, ashtu edhe ne drejtim te kualitetit transmetues i cili po kap parametra shume cilesore. Mendojme se nga nje dritare per ndegjuesit e saj, ajo shume shpejt do te kthehet ne nje ekran te gjere, ku secili mund te shijojte muzike dhe informacione, reklame dhe dhe ushqim shpirt-eror, telefonata dhe informacione nga mediat e shkruara dhe ato vizive, duke qene keshtu nje burim i



pashtershem mediatik per te gjitha ndigjuesit e saj. Por, te ndertosh nje media dhe ta hedhesh ate ne treg nuk eshte e lehte. Por, gjithashtu nuk eshte e lehte edhe mbijetesa dhe zgjerimi i saj. Prandaj, mendojme qe nje thirrje per qytetaret shkodrane qe ata t'i qendrojne pran-esa radioje, qe eshte ne sher-bim te tyre, do te ishte shume domethenese per mbarevajtjen e saj. Gazeta "Besimtari" e ka mirepritur "Radio Jehona" dhe i afron asaj bashkepunim duke synuar qe keto dy media te jene nje simbioze mediatike ne dobi te nje informacioni sa me te gjere dhe sa me cilesor, pa harruar edhe tematiken e saj ku do te evidentohen dhe do te mbrohen

vlera te rendesishme morale, sociale dhe nacionaliste per te cilat kane nevojte sot me shume se kurre te gjitha shqiptaret.

Radio Jehona po pergaditet te kaloje ne fazen e dyte te transmetimit, duke rritur gamen e programeve te saj. Prandaj, ju kujtojme se Radio Jehona mund te ndiqet nga ndegjesit dhe simpatizuesit e saj ne valet FM 107.6 M.H.z dhe kontakti me kete media mund te realizohet permes numurit cel. 693958844

Selim Gokaj

"JEHONES" MBARESIS I UROJ

Ne Shkoder Loce ne ditet tona,
Ambel valet jane tuje perkedhel,
Ajo asht "Radio Jehona",
Lule shprese asht tue cele.
E te gjitha duhet t'a dine,
Se ky za i therret te tane,
Per kah e mira ai prijn,
Jo vec ne Shkoder por n'cdo ane...
Kush ndihmon Zoti i nderoft,
E i shperbleft me miresi,
Puna mbar gjithmon iu shkoft,
Ky asht hap me largpamsi....

Lavdata kuj s'jam tue i thure,
Por nji gja duhet t'a dijm,
Kalaja s' bahet me nji gure,
Punve t' mira gati t'iu rrijm.
Edhe une kah do rrugoj,
Me vale t'shpirtit iu pershendes,
"Jehones" mbarsi i uroj,
Me zemer e shpirt i juaji mbes.

BURHAN FILI

Qershor 2009, U S A

INFORMACIONE MEDIATIKE NGA "ZERI I TURQISE" NE GJUHEN SHQIPE

SHQIPERIA NE ZEMREN E CDO TURKU ZE NJE VEND TE VECANTE

Presidenti i Shqiperise , Bamir Topi, ka pritur shefin e shtabit te pergjithshem te ushrise turke te cilin e ka dekoruar ne she-nje mirenjohjeje per kontributin qe po jep Turqia nr zhvillimin ekonomik dhe per mbeshtetjen e modernizimit te ushrise shqiptare ne kuadrin e Alence se Atlantikut Verior pjese e se ciles eshte ot Shqiperia. Duke e falenderuar presidentin shqip-

tar Bamir Topi per vleresimin qe i beri duke e dekoruar , shefi i shtabit te ushrise Turke deklaroi ne mes te tjerave se ne zemren e cdo turku Shqiperia ze nje vend te vecante , treguesky i lidhjeve historike ne mes te dy popujve te cilat vazhdojne te fuqishme edhe ne ditet tona me devizen e shqiptareve se edhe ne zemren e cdo shqiptari Turqia ze nje vend te vecante gje qe duket qarte tek qendrimi ne unison i publikut shqiptar ne mbeshtetje te turqise ne te gjitha

fushat duke filluar me ata ekonomike dhe duke vazhduar me fushen ushtarake.

PER TURQINE POPULLI I IRANIT ESHTË POPULL VELLA DHE MIK

Sapo kane perfnduar zgjedhjet parlamentare ne Iran ku fitues u shpall presidenti i tanishem , Ahmaddinexhat. Ajo qe te binte ne sy ishte nje pjesemarrje teper masive e votuesve qe kaperceu shifren 30%.Opozita i kontestoi keto zgjedhje si te manipulua-

ra, por udheheqesi shpirteror i Republikes se Irani Ajotollah Kohmein i shpalli ato te rregullta Qeveria e turqise deklaroi se ajo i quan zgjedhjet si pune e mbrendshme e Iranit dhe se turqia respekton dhe ka besim tek institucionet e Iranit. Ne nje deklarate tetij ministri i jashtem i Turqise e qyajti popullin e Iranit popull velle dhe mik, duke treguar se bashkimi i muslimaneve eshte sot nje mision i dites per Turqine ku synite dhe shite jane vellezer muslimane.

KOSOVA

*Shekuj me radhë prite Lirinë,
Shekuj me radhë vuajte tiraninë,
Shekuj me radhë në Ty qëndruan barbarët,
Shekuj me radhë në Ty vuajtën shqiptarët,
II.*

*Shekuj me radhë në Ty u pasuran tregëtarët,
Shekuj me radhë ata thonin se "jan të parët",
Shekuj me radhë në Ty u thy kulaqi,
Shekuj me radhë nga Ti u mor haraci,
III.*

*Shekuj me radhë Ty të shitën "miqët",
Shekuj me radhë, të poverhtësuan armiqët,
Shekuj me radhë ti lave në gjak,
Shekuj me radhë, ti nukpate fat,
IV.*

*Shekuj me radhë qendrove e okupuar,
Shekuj me radhë, durve torturen
Shekuj me radhë Prite një zë,
E LIRË, E LIRË JE TI, OJ KOSOVË, OJ NËNË.*

Kët vjerrshë, ja kam kushtuar familjes
heroike të Jashrave të Prekazit
Mustafa Hoxha
08.Marta.1998.

Beograd,Ul. Prvog Sremskog Odreda 75

POLTRONET

Ata jan të gatshëm në cdo situatë,
Vetën duk lavdëruar, ditën të bëjn natë,
Aftësi kan njerëzit t'i mashtrojnë
Gjithnji janë të gatshëm situates t'i adoptohen

II.

Kur populli është në robëri, ata ndërrojn
zagarët,
Kur flitet për liri, ata janë të parët,
Kur fillon lufta çlirimtare, nuk ndihen të
gjallë,
Kur vjen çlirimi, ata gjindën në ballë,

III

Në ballë të kolonës çlirimtare, ata brohoritin,
Të gatshëm vehten sheshazi ta ngritin,
Kinse, "sa ma larët moralin popullit të ia
ngritin,
Qëllimin e kan, kontributin e lirisë ta
grabitin,

IV

Kur ndodhë e dashura Liri,
Ata tparët turrën,
Që të gjejnë mundësi,
Me çlirimtarë të "mburrën"
Nën bisht duke ju hi
Ndonjë ashtë të cofët me lëpi

Mustafa Hoxha
Olten, Zvicër
Gusht 2008.

TRADHETARET

*Janë të betuar armikut ti shërbejn,
Po dhe vendi të kallët flakë,
Asgjë nuk kursejnë,
Popullin të ulin në gjakë,
-II-*

*Kur ndodhë Lirija,
Jo, tradhtarët nuk gëzohen,
Të mbuluar nga tradhtija,
Armikut i betohen,
-III-*

*Edhe pse okupatori i flliqët iku,
E u kthy në shtëpi të vetë,
Por, siq vepron armiku,
Në Kosovë i la klyshët,
te ushtruar me vjetë,
-IV-*

*Klyshët tradhtarë si qyqe,
Kan infiltëruar poltronët,
Që ne vendet kyqe
Të vendojn, pionët
-V-*

*Dukë u thirrë në demokraci,
Vlerë të imponuar,
Bajn çmos ata dilinxhi,
Vendin me shkatrruar,
-VI-*

*Mirë e kan të ditur,
Se popujt në Ballkan,
Fetarisht nuk jan aqë të ngritur,
Por, për fe kokën e lanë,
-VII-*

*Na propozojn "një fe shqiptare",
Nga Pashko Vasko Shkodrani,
Pa hy në analizë asë fare,
Pse Ai zotërij, natë botë ashtu bani,
-VIII-*

*Sulmojnë hoxhollarët,
Pse, "fëmijët ua shqetësojnë",
Qëllim kan tradhtarët,
Konfliktin shqiptarë -fetar të organizojnë,
-IX-*

*Të pa ngopur me gjak,
Ata në çdo shtresë të jetës,
Zejn vendet kyqe pa hak,
Për mposhtjen e të vërtetës.*

POLITIKE E RE E PRESIDENTIT OBAMA ME BOTEN MUSLIMANE

Ne viziten qe beri presidenti amerikan Obama ne disa vende te rendesishme te botes muslimane, ku perfshihen vizitat ne Turqi ,Egjipt, Arabi Saudite dhe ne vende te tjera te Lindjes se Mesme, u duken tregues te qarte te nje kursi te ri te politikës amerikane ndaj Botes Muslimane te cilet jane nje dukuri e kundert me politiken e forces dhe te genocidit qe ish-presidenti amerikan Bush zbatoi ndaj Botes Muslimane , politike qe solli nje armiqesi te dyfishte te botes muslimane ndaj Bushit dhe ndaj vete Sh.B.A.,pa harruar se ky qendrim i Botes Muslimane u rrezatua edhe ndaj atyre vendeve perendimore qe u bene pjese e politikës se Bushit ndaj Botes Islame.

Te mos harrojme se Turqia u rralit nder vendet me antiamerikane te globit , fjala eshte per popullin turk, pa harruar se edhe administrata shteterore turke nuk ishte dakort me kete politike te ashper amerikane kunder Botes Muslimane.Opinjoni publik, permes mediave dhe botimeve te shumta, u shokua kur u njoh me skenare dhe fakte qe vune ne dyshim vertetesine e 11 shtatorit dhe te disa akteve dhe veprimeve qe iu faturuan padrejtesisht muslimaneve, ku primadone mbetet burgu famekeq i Guantanamo. Por, duket se ATA, qe de fakto pergadisnin dhe planifikojne politiken e shtetit gjigand amerikan, e kane kuptuar se kursi Bush ia ka arrite qellimit dhe njekohesisht eshte edhe i deshtuar. Prandaj, u perpunua strategjia e re

ndaj Botes Islame te cilen ne terren po perpiqet ta zbatoje presidenti Obama e cila do te jete nje tregues pozitiv per te dy palet, sepse ka ardhur momenti kur Perendimi ta kuptojte se politika e forces ndaj Botes Islame eshte e pafuqishme per te zgjidhur problemet me te cilat perballohen sot popujt muslimane dhe ato te krishtere.Presidenti Obama, qe ne intervisten e pare qe mbajti, pasi hyri ne Shtepine e Bardhe, deklaroi se popujt muslimane jane miq e tij dhe jo armiq e tij. Ndersa ne nje interviste ne rrjetin televiziv Al-Arabia, ai deklaroi se ne disa raste SH.B.A kishin bere gabime dhe nuk ishin sjelle ne menyre te perkryer me Boten Islame. Ne edhe mund te kemi mosmarrveshtje ,por Botes Muslimane ne i shtrijme doren e miqesise- ka

deklaruar presidenti Obama. Por, hendeuku nuk mund te mbyllet me deklarata, sado qe ata te jene publike dhe zyrtare, sepse mbetet per te bere shume qe ky hendek te zvoglohet dhe te shkoje drejt mbylljes, sepse Iraku dhe sidomos Afganistani mbeten plage te hapura per Boten Islame.Atje sot lufta vazhdon dhe vrasjet e njerezve te pafajshem nuk kane te mbaruar, ku femijet jane viktimat me te pafajshme.Por politika qe po zbaton presidenti i ri amerikan eshte nje veprim qe duhet pershendetur dhe nderuar, sepse ai eshte nje gur i rendesishem qe po vendoset ne themelet e paqes ne te gjithe boten.

Alban Kastrati

MAJKELL XHEKSON VARROSET ME RREGULLA ISLAME

Admiruesit e muzikes rok ne te gjithë boten humbenkengëtarin legjende te kesaj muzike, Majkell xhekson, i cili nderroi jete pak dite me pare pas nje goditjeje ne zemer. Flitet se mjeku i tij personal mban pergjegjesi per mbidozen e ilaceve me te cilat ka kuruar kengetarin e njohur. Prandaj, sot ky mjek po kerkohet nga drejtesia amerikane

per te deshmuar per akuzat qe i jane adresuar atij ne lidhje me vdekjen e Majkell Xheksonit. Kurse te dhenat me te fundit flasin edhe per 5 mjeke te tjere qe po kerkohen nga drejtesia amerikane, sepse akuzohen direkt per pjesemarrjen e tyre ne vdekjen e Majkell Xheksonit. Nje angazhim i tille i mjekeve per vrasjen e kengetarit te njohur qe u konvertua ne Islam te ben te dyshosh per nje prapavije misterioze qe qendron pas

ketyre mjekeve kriminele qe vrane Majkell Xheksonin Pasi eshte hapur testamenti i tij, ka dale ne drite kerkesa e te ndjerit per t'u varrose sipas rregullave islame, sepse eshte pranuar qe Majkell Xhekson ka me se tre vite qe eshte konvertuar ne fene islame, pohim ky i njohur permes mediave nga opinjoni publik boteror.Konvertimi ne fene muslimane e ketij kengetari, i cili qendroi me dekada te tera ne majen e piramides

se muzikes boterore, tregon se tek feja islame njerezit po gjejne qetesine e vertete shpirtore dhe vlere te pakufizuara permes mesazhit islam te cilin ata e kane bere tashme pjese te jetes se tyre.

Informacion mediatik

INTERVISTE ME REISU-L-ULEMA MUSTAFA CERIQ DHENE GAZETES VEECERNE NOVINE

Vecerne Nevine: Boshnjaketjane te zhgenjyer me Perendimin dhe qendrimin e tij. Si mendon ne pergjithesi Perendimi per kete?

Ruisu-l- Ulema:Cfare keni

parasysh kur thoni Perendimi? Perendimi duhet vleresuar nga veprat dhe jo nga fjalet.Perendimi ka shkaktuar ndarje ne menyre qe te perfitoje.Shikoni ju lutem sa shtete te vegjel ka krijuar ai nga plateja e madhe unike arabe.Atje per shekuj me rralle disa Ven-

se dhe Ouene kane vizatuar kufinj si po vizatojne edhe sot ne Bosnje., me gersheret e te cileve po presim mishin e muslimaneve.Kjo eshte kesh-tu, po, po, keshtu eshte.Perendimi? Perendimi personifikon nje bote e cila vlerson me shume nje pike nafte se sa

nje liter gjak muslimani.

Materjali eshte marre nga botimi "Besimi fetar, Feja dhe Atdheu"

Space-center

Qendra e internetit space-center ju ofron:

- internet te shpejte,
- shperndarje interneti,
- programe te ndryshme,
- cd, dvd, mp3,
- servis kompjuterash
- printime, skanime, etj.

Te gjitha keto me nje sherbim cilesor e te kulturuar.
Jemi hapur cdo dite nga ora 08:00 deri 23:30.

Adresa: pallati xhenis pas rektoratit te universitetit
"luigj gurakuqi", kati I

Kontakte:

- e-mail: spacecenter@live.com
- Cel. 0693253723 / 0672944162

SHKODRA PRITI ME PLUMBA FASHISTET ITALIANE

Pushtimi fashist i Shqiperise, me 7 Prill 1939, ishte pjese e planeve te vjetra te Italisë per te pushtuar dhe kolonizuar Shqiperine, te cilen e quante gjithmone nje kafshate që kishte pranë gojës së saj të cilen, mjaftonte qe ta hapte gojën dhe Shqiperia do të përfundonte ne stomakun e saj. Por, historikisht kjo kafshatë ka qenë e vështire për të përfunduar ne stomakun e Italisë, gjë që ishte pare sidomos në luftën e Vlorës, kur ushtarët italianë e panë vehten në det nga rezistenca e luftëtarëve shqiptarë e cila duket se ishte kockë e forte

që u mbetet në grykë kujdo që tenton ta kapërdijë atë. Por, prilli i vitit 1939 ishte i vështire për shqiptarët, sepse u ndeshën me nje ushtri italiane që sulmoi Shqipërinë për të realizuar pikërisht planet e vjetra ne kohe të reja, duke demonstruar forcën pushtuese permes nje ushtrie shumë të armatosur. Shkodra, si e gjithë Shqiperia, u tha fashisteve italiane se pushtuesi eshte pritur vetem me plumba, pavaresisht mundesive te kufizuara per te rezistuar .Deshmitaret e atyre diteve tregojne se repartet ushtarake italiane u ndaluan tek ura e Bahçallekut dhe kishin frikë të hynin në qytet pa një siguri

nga përfaqësuesit e qytetit. Duket se forcat politike të atyre viteve në Shkoder vendosën ta shpallin atë qytet te hapur, që ta shpëtonin nga një ndeshkim i mundshëm ushtarak. Prandaj, përfaqësues pushtetarë të asaj kohe, të mbështetur edhe nga kleri i tre religjoneve i siguruan fashistët se nuk do te kishin rezistencë nga repartet ushtarake të Shkodres.Por, sapo motoçikleta e parë e fashistëve shkeli mbi urën e Bahçallekut, u ndëgjun të shtenat e një mitrolozi të rendë nga lartësia e kalasë së Shkodrës dhe oficeri, së bashku me motorin e tij, u përmbysën mbi urë. Kjo ishte përgjigja

e vërtetë që Shkodra u dha pushtuesve italianë në prill të vitit 1939, duke u treguar atyre se janë miq të paftuar dhe se miq e paftuar Shkodra dhe shkodranët i kanë pritur gjithmonë vetëm me plumba. Të habit fakti përse brezave pasardhës u përcillet pak dhe me rezerva akti i atyre trimave qe u vunë mitrolozin pushtuesve italiane ne prill te vitit 1939, në një kohë që patriotizmi është një dukuri me të cilin brezat duhet të edukohen gjithmonë

Vëzhguesi